



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:110759

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06632408

P.nr.314/24

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale, kundër të pandehurit E.H, nga fshati ....., i komunës së Deçanit, i akuzuar për shkak të veprës penale "Sulmi" nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.470/2024, të datës 12.04.2024, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 10.12.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i dëmtuari M.A si dhe i pandehuri E.H, me datë 11.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

**I pandehuri:**

**E.H**, i lindur me datë ..... në fshatin ....., me vendbanim në rr. ".....", me nr. ...., në fshatin ....., Komuna Deçan ku edhe tani jeton, nga i ati O., dhe e ëma S., e gjinisë ....., i martuar, baba i .... fëmijëve, ka të kryer shkollën e fillore, me profesion ....., me nr. tel. ...., i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ID ..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

Ë S H T Ë F A J T O R

**Për shkak se:**

*Me datë 28.02.2024 rreth orës 22:20, në rrugën .....-Pejë, pikërisht në lokalit "....." me dashje e përdor forcën ndaj këtu të dëmtuarit M.A, në atë mënyrë që ditën kritike deri sa i dëmtuari ishte duke ngrënë bukë në lokalit ".....", i pandehuri i afrohet të dëmtuarit M. duke i thënë "a je bërë djalë i mirë" dhe më pas e godet me grushte tre herë në fytyrë dhe duke e kërcënuar me fjalët si "mos i trego kurrkujt për sonte çka ndodhi këtu, e kurrsesi mos e lajmëro policinë", me qka tek i dëmtuari shkakton frikë dhe ankth,*

-Me çka ka kryer veprë penale "Sulmi" nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72 dhe 184 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe neneve 240, 241 paragrafi 1, 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 24, 242 paragrafi 6, 364, 449 paragrafi 1 dhe 2 dhe nën paragrafi 2.6, 450, 452 paragrafi 1 dhe 462 paragrafi 2 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

- I.** Me **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej njëmijë (1000) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj brenda afatit prej tre (3) muajsh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- II.** Nëse i pandehuri, nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e cekuar si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata do të e zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro gjobë, do ti llogariten barabartë me një (1) ditë burgimi.
- III.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobë në tërësi, gjykata do të e zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV.** Konform nenit 452 par. 4 të KPPRK-së, i pandehuri, lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe taksës për kompensimin e viktimave të krimit, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.
- V.** I dëmtuari M.A, me vendbanim në rrugën “.....”, nga fshati ....., i komunës së Pejës, ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 12.04.2024, ka ngritur aktakuzë nën shenjen PP/II.nr.470/2024, ndaj të pandehurit E.H, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.12.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit M.A si dhe të pandehurit E.H.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraparakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për

veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim dhe se i njëjti është i penduar, i vie keq për atë se çfarë ka ndodhur, dhe se të dëmtuarit i kërkon falje.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç’rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*, ngjashëm është deklaruar edhe i dëmtuari M.A i cili deklaroi së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjenë mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti fillestar Incidentit me nr.2024-DA-293 nga F.L. CP11912 dt. 28.02.2024, Raporti Oficerit 2024-DA-293 të datës 29.02.2024 nga F.. L. CP11912, Raporti Informues nga S. H. #2746 e dt.29.02.2024, Deklarata e të dëmtuarit M.A e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt.28.02.2024, Deklarata e të pandehurit E.H e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt.07.03.2024, Raport mbi të kaluarën kriminale të të pandehurit E.H.*

Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj i propozoi gjykatës: *që në kuptim të rrethanave rënduese të marr parasysh ndonjë dënim të mëparshëm eventual të të pandehurit ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I dëmtuari M.A, ka deklaruar se: *i pandehuri nuk me ka kërkuar falje deri më tani, me të nuk jemi takuar që nga ajo ditë, konflikte të tjera nuk kemi pasur, vazhdojë të ndjehem i rrezikuar nga i pandehuri, nuk dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike.*

I pandehuri E.H, ka deklaruar së: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i kërkoj falje të dëmtuarit, i premtoj Gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, e ndjej veten të penduar, jam baba i tre fëmijëve dhe nuk kam kohë të mirrem.*

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se i njëjti është i dënuar me dënim me burgim me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë, i evidentuar nën shenjën P.nr.05/13, i plotfuqishëm me datën 28.03.2013, për veprën penale “Grabitja” nga neni 255 par.1 të KPK-së, është dënuar me kusht me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, i evidentuar nën shenjën P.nr. 124/2022 për veprën penale të “Vjedhje e pyllit” nga neni 349 par.3 pika 3.1 të KPRK-së, i plotfuqishëm nga data 05.12.2022.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të tij e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, mbi këto arsye, gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin me burgim të kushtëzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 184 paragrafi 1 e lidhur me nenin 48 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 50 paragrafi 2 të KPRK-së, gjykata do të revokojë dënimin e kushtëzuar nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, andaj ka vendosur si në pikën e III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin që i pandehuri të lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë konform nenit 452 par. 4 të KPRK-së, për faktin se i njëjti ka gjendje të rëndë ekonomike konkretisht e njëjti është shfrytëzues i socialit në shumën prej 120 euro në muaj dhe se me detyrimin eventual të tij me pagesë të shpenzimeve procedurale, gjendja e tij ekonomike do të rëndohet edhe më shumë.

I dëmtuari M.A, nga fshati ....., rr. “.....” p.nr, Pejë, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike, respektivisht nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë, andaj mbi këtë arsye gjykata, e në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 458, 459 dhe 460 të KPRK-së, të dëmtuarin nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 314/24, me datë 20.12.2024.**

**Zyrtarja ligjore**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Blerinda Laiq**

**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.